



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA KONISPOL**

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: **BLERJE KARBURANTI**

- Fondi limit **12 500 000** (*Dymbëdhjetë milionë e pesëqind mijë*) **Lekë , pa TVSH**
- Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë

Lloji procedurës së prokurimit të jetë : **E Hapur**

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Nga data e nënshkrimit të kontratës deri në 31.12.2024**

- Sasia e mallit të kërkuar: Përafërsisht 87 683 litra Gazoil 10ppm në varësi të çmimit në bursë referuar procesverbalit të përlogaritjes së fondit limit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia KONISPOL** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

*Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojcë*

### Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer xhiro mesatare vjetore në një vlerë jo më të ulët se fondi limit për të paktën njërin nga vitet 2022 ose 2023.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:*

- *Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet e sipër përmendura.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik: b) *vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatimit Taksave) për vitet 2022 dhe 2023 ku raporti ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është negativ.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Ofertuesi duhet të provojë se ka shlyer detyrimet vendore për vitin 2023.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:*

- Vertetim të leshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara për vitin 2023

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme i referohet zbatimit të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore i ndryshuar.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Furnizime të ngjashme në një vlerë prej (40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet) të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

*Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:*

1. Kontrata të ngjashme për furnizime me entin që ka realizuar këtë lloj furnizimi e shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses nga autoriteti kontraktor ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura/t tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”... *vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi ose licencë për tregtim karburantesh nga organi kompetent në zbatim të ligjit Ligjit nr.8450 date 24.02.1999.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”* nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë-analize për produktin Diesel 10PPM sipas standardit **SSH EN 590:2022**, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj duhet përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregton.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.4** Operatori ofertues duhet të ketë pikë furnizimi me karburant në territorin e Bashkisë Konispol ose kontratë bashkëpunimi me një të tillë.

Për këtë të paraqitet dokumenti i pronësië, ose kontrata e qirasë/bashkëpunimit. Kontrata e qirase ose e bashkëpunimit duhet të jenë të lidhura pranë noterit me afat vlefshmërie që të përfshijë afatin e ekzekutimit të kësaj kontrate dhe e shoqëruar me dokumentet e pronësisë dhe autorizimin e stacionit të shitjes së karburantit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter shërben për të treguar se ofertuesit i kanë kapacitetet teknike lidhur me ekzekutimin e kontratës.

- **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Specifikimi i Materialeve:

Të dhënat teknike i referohen standardit **SSH EN 590:2022** “Lëndë djegëse e lëngët për automjete-Gazoil(10ppm). Kërkesat dhe metodat e proves” të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

Nr	Treguesit cilësor	Njësia matjes	Normat e lejuara	
			minimale	maksimale
1.	Numri i cetanit		51	
2.	Indeksi i cetanit		46	
3.	Densiteti në 15 °C	kg/m <sup>3</sup>	820	845
4.	Hidrokarburët aromatikë policiklikë	% (m/m)	-	8
5.	Përmbajtja e sqfurit	ppm	-	10
6.	Pika e flakërimit	°C	55	
7.	Përmbajtja e C karbonit (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30
8.	Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01
9.	Përmbajtja e ujit	% (m/m)	-	0.02
10.	Ndotja e përgjithshme	mg/kg	-	24
11.	Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1	
12.	Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m <sup>3</sup>	-	25
13.	Viskoziteti kinematik në 40 °C	(cSt)	2	4,50
14.	Distilimi			
15.	Distilimi distilati që vlon deri në 250°C	% (V/V)		65
16.	Distilati që vlon deri në 350 °C	% (V/V)	85	
17.	95 % (ne volum) i tij distilon në	°C	360	

- **Afatet e lëvrim:**

**Nga data e lidhjes së kontratës deri në 31.12.2024. Nëse nuk është tërhequr gjithë sasia në përfundim të kontratës, bashkia Konispol ka t drejtë ta tërheqë sasinë e mbetur gjatë vitit pasardhës.**